

Tobacco Holding Group sh.p.k
Raporti i Pasqyrave Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Përmbajtja

| | Faqe |
|-----------------------------------------|------|
| Pasqyra e pozicionit financiar | 1 |
| Pasqyra e Performancës | 2 |
| Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare | 3 |
| Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto | 4 |
| Shënimet e pasqyrave financiare | 5-26 |

Pasqyra e Pozicionit Financiar 2022

Me ndarje ne afatshkurter dhe afatgjate

| | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|---------------------------------------------------------------------|------------------------|--------------------------|
| AKTIVET | | |
| Aktive afatgjate | | |
| Aktive afatgjata materiale | 937,920,228 | 806,281,124 |
| Investime ne pjesmarrje | 222,670,000 | 222,670,000 |
| Aktive te tjera (pershkruaj) | | |
| Totali i aktiveve afatgjate | 1,160,590,228 | 1,028,951,124 |
| Aktive afatshkurtra | | |
| Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter | 1,189,344,982 | 986,114,082 |
| Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme | 653,245,259 | 591,735,685 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 82,873,313 | 181,935,519 |
| | 1,925,463,555 | 1,759,785,284 |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | 1,925,463,555 | 1,759,785,284 |
| TOTALI I AKTIVEVE | 3,086,053,782 | 2,788,736,408 |
| DETYRIMET DHE KAPITALI 2022 | | |
| Kapitali dhe Rezervat | | |
| Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit | 71,630,000 | 71,630,000 |
| Rezerva ligjore | 2,008,815 | 2,008,815 |
| Fitimet/(humbje) te mbartura | 661,992,643 | 531,275,278 |
| Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike | 735,631,458 | 604,914,093 |
| Totali i kapitalit | 735,631,458 | 604,914,093 |
| Detyrime afatgjate | | |
| Huamarrje (leasing) | 35,881,542 | 50,635,662 |
| Totali i detyrimeve afatgjate | 35,881,542 | 50,635,662 |
| Detyrime afatshkurtra | | |
| Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme | 394,353,821 | 474,054,599 |
| Te ardhura te tjera | 580,116,474 | 370,858,783 |
| Huamarrje | 1,333,861,985 | 1,285,173,951 |
| Detyrime financiare te tjera | 3,618,372 | 812,128 |
| Detyrime per tatimin actual | 2,590,131 | 2,287,192 |
| | 2,314,540,783 | 2,133,186,653 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | 2,314,540,783 | 2,133,186,653 |
| Detyrime totale | 2,314,540,783 | 2,183,822,315 |
| TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT | 3,086,053,782 | 2,788,736,408 |



Pasqyra e Performances (sipas natyres)

| | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|-------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|-----------------------|
| Aktivitetet e vazhdueshme | | |
| Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit | | |
| <i>To ardhurat nga aktiviteti kryesor</i> | 9,351,871,169 | 7,991,324,238 |
| <i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i> | 25,822,731 | 48,531,043 |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | -8,717,624,971 | -7,446,188,407 |
| Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi | -69,476,766 | -63,941,926 |
| Shpenzime personeli | -129,746,459 | -121,843,969 |
| Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto | -37,493,639 | -25,421,934 |
| Shpenzime te tjera | -269,459,922 | -266,136,334 |
| Te tjera (pershkruaj) | | |
| Fitimi/(humbja) para tatimit | 153,892,142 | 116,322,711 |
| Tatimi mbi fitimin | -23,174,777 | -17,689,405 |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes nga aktiviteti i vazhdueshem | 130,717,366 | 98,633,306 |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes (A) | 130,717,366 | 98,633,306 |
| Fitimet per aksion | | |
| Nga aktivitetet e vazhdueshme | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes (A) | 130,717,366 | 98,633,306 |
| Te ardhura te tjera gjithepershires | | |
| Vlera qe nuk do te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Fitime nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Pjesa e te ardhurave gjithepershires nga pjesmarriet | | |
| Shuma | 0.0 | 0.0 |
| Vlera qe mund te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje | | |
| Fitime/(Humbje) nga mbrojtja nga fluksi i mjeteve monetare (Cash Floë Hedges) | | |
| Tatim fitimi i vlerave qe mund te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Shuma | 0.0 | 0.0 |
| Totali i te ardhurave te tjera gjithepershires per periudhen pas tatimit (B) | 0.0 | 0.0 |
| Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen (A+B) | 130,717,366 | 98,633,306 |

Hartuesi

Brunilda Heco



Administratori

Valbona Beqiri

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)

| | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|----------------------------------------------------------------------------|---------------------|-----------------------|
| Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit: | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes | 130,717,366 | 98,633,306 |
| Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare: | | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | | |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 69,476,766 | 63,941,926 |
| Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera | -61,498,740 | -160,500,857 |
| Renie/(Rritje) ne inventar | -203,230,900 | -105,095,559 |
| Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme | -31,023,579 | -71,722,202 |
| Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit | 3,109,183 | -5,057,389 |
| Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | -92,449,905 | -179,800,776 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale | -201,115,870 | -125,774,297 |
| Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | |
| Arketime nga shitja e investimeve te tjera | 209,257,691 | 125,916,351 |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit | 8,141,821 | 142,053 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | | |
| Pagesa e huave | -14,754,120 | 206,048,614 |
| Pagese e detyrimeve te qirase financiare | | |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | -14,754,120 | 206,048,614 |
| Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to | -99,062,205 | 26,389,891 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim | 181,935,518 | 155,545,627 |
| Efekt i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund | 82,873,313 | 181,935,518 |

Hartuesi

Brunilda Jeka



Administratori

Valbona Beqaj

Tobacco Holding Group

Shenime mbi pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

(*To gjitha shumat jane ne LEK, nese nuk shprehet ndryshe*)

Pasqyra e lëvizjes në kapitalin neto

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva rivlerësimi | Rezerva te tjera (përshkruesh) | Rezerva te tjera (përshkruesh) | Fitimet/ (humbjet) e pushperndarës | Fitim/(humbja) e periudhës | Totali | Totali |
|------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|---------------------|--------------------------------|--------------------------------|------------------------------------|----------------------------|-------------|-------------|
| pozicioni financiar ne fillim | 71,630,000 | - | 2,008,815 | - | 300,565,404 | 132,076,568 | 506,280,787 | 506,280,787 |
| Efektë i ndryshimeve ne politikat kontabile | - | - | - | - | - | - | - | - |
| pozicioni financiar i rindehnuar ne fillim | 71,630,000 | - | 2,008,815 | - | 300,565,404 | 132,076,568 | 506,280,787 | 506,280,787 |
| Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhës: | | | | | | | | |
| Fitim/(humbja) e periudhës | | | | | | 98,633,306 | 98,633,306 | 98,633,306 |
| Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse | | | | | | | | |
| Tatime skenule dhe te shlyera te njohura drejtpendur ne kapital | | | | | | | | |
| Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen | | | | | | 98,633,306 | 98,633,306 | 98,633,306 |
| Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital: | | | | | | | | |
| Emetimi i kapitalit te nënshkruar | | | | | | | | |
| Dividende te shpandura | | | | | | | | |
| Percaktime te tjera per rezultatit e periudhës (përshkruesh) | | | | | | | | |
| Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike | | | | | | | | |
| pozicioni financiar ne fund (viti pararendës) | 71,630,000 | - | 2,008,815 | - | 300,565,404 | 230,709,874 | 604,914,093 | 604,914,093 |
| Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhës: | | | | | | | | |
| Fitim/(humbja) e periudhës | | | | | | 130,717,366 | 130,717,366 | 130,717,366 |
| Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse | | | | | | | | |
| Tatime skenule dhe te shlyera te njohura drejtpendur ne kapital | | | | | | | | |
| Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen | | | | | | 130,717,366 | 130,717,366 | 130,717,366 |
| Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital: | | | | | | | | |
| Emetimi i kapitalit te nënshkruar | | | | | | | | |
| Dividende te shpandura | | | | | | | | |
| Percaktime te tjera per rezultatit e periudhës (përshkruesh) | | | | | | | | |
| Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike | | | | | | | | |
| pozicioni financiar ne fund (viti aktual) | 71,630,000 | - | 2,008,815 | - | 300,565,404 | 361,427,240 | 735,631,459 | 735,631,459 |

Hartuesi

Brumilda Heco
[Signature]



Administratori

[Signature]
Valbona Beqiu

1. Informacion mbi Shoqerine

Shoqëria "Tobacco Holding Group" shpk është themeluar me vendimin nr 25503 datë 25.03.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës. Ajo është shoqëri e formës juridike me përgjegjësi të kufizuar. Objekti i saj kryesor eshte aktiviteti i distribuimit te artikujve të konsumit si pijeve, cigareve kryesisht te furnizuara nga shoqëria BATA (British American Tobacco Albania), Pernod Ricard Slovenia, PEJA sha, etj.

Administrator i shoqërisë është Znj. Valbona Begu.

Adresa e Shoqërisë është Rr. Feridon Fezollari, ish Kombinati Ushqimor, ndërtesa THG, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT K11724001B.

Për vitin 2022 numri mesatar i punonjësve është **126** persona.

Gjatë vitit 2022 nuk ka patur ndryshime në strukturën dhe madhësinë e kapitalit themeltar të shoqërisë. Me 31 Dhjetor 2022 struktura e kapitalit paraqitet si më poshtë:

| Ortakët | Perqindja e zotërimit | Shuma e kapitalit ne lekë |
|-----------------|-----------------------|---------------------------|
| Lirim Fezollari | 99.32% | 71,140,000 |
| Kosta Jankovski | 0,35% | 250,000 |
| Zoran Jankovski | 0,33% | 240,000 |
| Totali | 100% | 71,630,000 |

Shoqëria disponon kontrata kryesore që i mundësojnë asaj aktivitetin normal si psh kontratat e punësimit, kontratat e qirave, kontratat e telefonisë, etj. si edhe kontratat kryesore të distribucionit me BATA, Pernod Ricard Slovenia dhe Peja sha.

2. Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare te Shoqerise jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te leshuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit. Keto standarte jane të detyrueshme në bazë të Urdhrit të Ministrisë së Financave nr.65, date 25 maj 2008 "Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe."

Pasqyrat Financiare jane pergatitur mbi parimin e kosos historike. Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Lek dhe te gjitha vlerat jane rrumbullakosur ne me te aferten njeshe (0.00), me perjashtim te rasteve kur eshte specifikuar ndryshe.

Shoqëria i mban të dhenat e kontabilitetit dhe i publikon pasqyrat financiare në pajtueshmëri me ligjin mbi kontabilitetin nr. 25, datë 10 maj 2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

3.Gjykimet dhe vleresimet kryesore kontabel

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve, si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese shoqëruese, si dhe zbulimin e detyrimeve të kushtezuara.

Pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve ose detyrimeve të prekura në periudhat e ardhshme.

Vleresimet dhe supozimet

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar të ardhshëm, përshkruhen më poshtë. Shoqëria ka bazuar supozimet dhe vlerësime të saj mbi parametrat në dispozicion kur janë përgatitur pasqyrat financiare. Megjithatë, rrethanat ekzistuese dhe supozimet rreth zhvillimeve të ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të tregut ose rrethanave që dalin jashtë kontrollit të Shoqërisë. Këto ndryshime reflektohen në supozimet kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Zhvlerësimi ekziston kur vlera bartëse e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme, e cila është më e lartë në vlerën e saj të drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes së depozitimit bazohet në të dhënat e disponueshme nga transaksionet e detyrueshme të shitjeve, të kryera në krahun e tyre, për aktivet e ngjashme ose çmimet e tregut të vëzhguara minus kostot shtesë të vendosjes së aktivitetit. Shoqëria e konsideron vlerën në përdorim atë vlerë e cila paraqitet në regjistrimet kontabel, pasi ka aktivitetet tregtar. Supozimet kryesore të përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme, duke përfshirë një analizë të ndjeshmërisë, janë shpalosur dhe shpjegohen më tej në Shënimin 4 dhe 7.

Tatim fitimi

Shoqëria është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Nevojitet një vlerësim i rëndësishëm në përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimi aktual dhe të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi i fundit i tatimit është i pasigurt. Shoqëria njih detyrimet për çështjet e auditimit të parashikuar të tatimeve bazuar në vlerësime nëse do të jenë detyrime shtesë. Kur rezultati përfundimtar i taksave të këtyre çështjeve është i ndryshëm nga shumat që janë regjistruar fillimisht, ndryshimet e tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe të shtyra të tatimeve në periudhën në të cilën bëhet një përcaktim i tillë.

Provizioni për nxjerrje jashtë përdorimit

Shoqëria nuk ka njohur një provigjion për detyrimet e mundshme lidhur me aktive në pronesi të saj. Në përcaktimin e vlerës së drejtë të provizionit, supozimet dhe vlerësime bëhen në lidhje me normat e skontimit, koston e pritjes për çmontimin dhe largimin e uzinës nga vendi dhe kohën e pritshme të këtyre shpenzimeve.

Parimi i vijimesise

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi parimin e vijimesise i cili konsideron se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj në një të ardhme të parashikuar.

Shoqëria ka pasur fitim për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2022 me vlerë **130,717,365 Leke**

dhe vlera e detyrimeve afatshkurtra e kalon vleren e aktiveve afatshkurtra per 2,314,540,783.

Shoqëria Tobacco Holding Group konfirmon qe eshte ne politiken e saj qe te jete ne gjendje te permbushi detyrimet dhe ne afatin e duhur dhe drejtuesit e Shoqërisë besojne se eshte me e pershtatshme qe tabelat financiare te pergatiten ne bazen e biznesit ne vijimesi. Prandaj, aktivet dhe detyrimet regjistrohen në bazë të asaj se njësia ekonomike do të jetë në gjendje të realizojë aktivet e saj dhe të kryejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit.

4.Permbledhje e politikave te pergjithshme kontabel

Politika kontabel janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyrat financiare.

a) Transaksionet ne monedhe te huaj

Monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë është Lek Shqiptar ("ALL"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha në të cilën raportohen këto pasqyra financiare.

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen në monedhën funksionale në normën e përcaktuar në datat e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja rivleresohen në kursin e këmbimit që vendoset në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në valutë në zerat monetarë është diferenca që rezulton nga përkthimi i një numri të caktuar të njësive të një monedhe të huaj në lekë me kurse të ndryshme të këmbimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë janë kembyer në lekë me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Kursi i këmbimit në fund të vitit 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 eshte paraqitur si me poshte:

| Monedha | 31 Dhjetor 2022 | 31 Dhjetor 2021 |
|---------|-----------------|-----------------|
| EUR/LEK | 114.23 | 120.76 |
| USD/LEK | 107.05 | 106.54 |

b) Aktivet afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

| | <u>2021</u> | <u>2020</u> |
|----------------------|-------------|-------------|
| Ndertesa | 5% | 5% |
| Pajisje dhe makineri | 10% | 10% |
| Pajisje zyre | 20% | 20% |
| Pajisje informatike | 25% | 25% |
| Mjete transporti | 20% | 20% |
| Te tjera | 20% | 20% |

Nje zë i aktiveve afatgjata materiale c'regjistrohet kur nxirret jashte perdorimit apo shitet ose kur nuk priten perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje qe rrjedh nga mosnjohja (c'regjistrimj) i aktivitet (llogaritur si difference mes te ardhurave nga pakesimi dhe vleres kontabel te aktivitet), paraqitet ne te ardhura ose shpenzime kur aktivi c'regjistrohet.

Vlera e mbetur e aktivitet, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen cdo periudhe financiare, duke bere ndryshimet e nevojshme sipas rastit ne fund te cdo viti financiar.

c) Aktivet afatgjata jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga Shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktiviteti specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mire dhe markës, njihen në fitim ose humbje në momentin e ndodhjes.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë vjetore amortizimi 20% për cdo aktiv.

d) Zhvlerësim i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohej flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

e) Inventarët

Inventarët mbahen në vlerën më të ulët të koston dhe të vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin koston direkte dhe ato indirekte që janë shkaktuar për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e inventarëve përfshin: koston e blerjes së mallit, koston e transportit, detyrimet doganore, akcizën etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

Manaxhimi i Shoqërisë gjatë vitit monitoron në mënyrë periodike çmimet e shitjes me koston e inventarëve dhe në qoftë se çmimi është ulur nën koston, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse si zhvlerësim i inventarëve.

Kostoja e inventarëve është e bazuar në metodën mesatare të kostos. Zhvlerësimi i përshtatshëm për ulje të vlerës njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja

f) Instrumentat Financiare

Politika e aplikuar për pasqyrat financiare të përgatitura pas datës 1 janar 2021

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre dhe llogari të pagushme tregtare dhe të tjera.

Aktive Financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet e saj financiare në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Shoqëria ka vetëm të arketueshme tregtare dhe të tjera të cilat mbahen me koston e amortizuar pasi Shoqëria i mban vetëm për pagesa të principalit dhe interesit (VPPI) për shumën kryesore të papaguar.

Aktivitetet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se mbartin interes) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimi). Fitimet dhe humbjet njihen në të ardhura ose shpenzime kur aktivi rregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Shoqëria rregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk rregjistrohen.

Shoqëria njih një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. HPK bazohen në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhet në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve monetare që Shoqëria pret të marrë, duke i zbritur një përaftrim të normës fillestare të interesit efektiv.

Për të arketueshmet tregtare dhe të tjera, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e HPK. Prandaj, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njih një zhvlerësim bazuar në HPK-në për të gjithë jetëgjatësinë e të arketueshmes në çdo datë raportimi. Shoqëria ka njohur një HPK prej 100% për të gjitha të arketueshmeve përjashtuar të arketueshme tatimore (TVSH).

Detyrimet Financiare

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet ose të pagueshme. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare dhe të tjera të pagueshme të cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

Kompesimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë njëkohësisht.

Te drejta dhe te tjera te arketueshme

Te drejtat dhe te tjera te arketueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Pas matjes fillestare, aktivet e tilla financiare maten më pas me koston e amortizuar, minus zhvlerësimi. Humbjet që rrjedhin nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kostot financiare për huatë dhe në koston e shitjeve ose shpenzimet e tjera operative për të arkëtueshmet. Për më shumë informacion mbi të arkëtueshmet, referojuni Shënimit 8.

Mjete Monetare

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë bilancet e parave të gatshme dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllimet e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare, paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra siç janë përcaktuar më sipër, neto nga mbitërheqjet e papaguara të bankave.

Politika e aplikuar për pasqyrat financiare të përgatitura para datës 1 janar 2021

Shoqëria i klasifikon aktivet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme: me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme, investimet e mbajtura deri në maturim dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin janë marrë investimet. Manaxhimi përcakton klasifikimin e investimeve të tij në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë përcaktim në çdo datë raportimi.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale mbi aktivin financiar në një transaksion në të cilin në thelb të gjitha rreziqet dhe

përfitimet e pronësisë së financimit asetet transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose pasivi e veçantë.

Një detyrim financiar nuk rregjistrohet kur detyrimi sipas detyrimit zbatohet ose anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si de-njohja e pasivit fillestar dhe njohja e një përgjegjësi e re. Diferenca në vlerën kontabël neto njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë njëkohësisht. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, paranë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, dhe detyrimet tregtare dhe të tjera.

Shoqëria nuk ka aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, të mbajtura deri në maturim ose të vlefshme për shitje.

a) Aktive financiare

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidence objektive që ai është i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet të jetë i zhvlerësuar nëse evidencat objektive tregojnë se një ose më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të ardhshme të vlerës së atij aktivi.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitet.

Asetet financiare individuale të rëndësishme janë testuar për zhvlerësim në baza individuale. Asetet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në fitim ose humbje) dhe pasqyrohen në një llogari zbritjeje ndaj aktivitet financiar. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ndryshimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar, ndryshimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në fitim ose humbje). Te drejtat dhe të tjera të arkëtueshme janë plotësisht të zhvlerësuar nga Shoqëria.

b) Aktivitet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale janë paraqitur me kosto historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së artikujve.

Shpenzimet e mëposhme përfshihen në vlerën kontabël të aktiveve ose njihen si një aktiv i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Amortizimi aplikohet në bazë të linjës së drejte gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Amortizimi është i ngarkuar kur aktivi është i gatshëm për përdorimin e synuar, duke konsideruar ndryshimin e politikës edhe pse në rastin konkret nuk ka ndikim pasi nuk ka shtesa të reja. Vlera e mbetur e aktivitet dhe jeta e dobishme rishikohen dhe përshtaten nëse

është e përshtatshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabel e një aktivi zbritet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabel neto e aktivit tejkalon shumën e rikuperueshme.

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale dhe cdo pjesë e konsiderueshme e njohur fillimisht çregjistrohet kur përdoret ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose asgjësimi i tij. Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale, njihen neto në "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

c) Aktive jo financiare

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqerise, perveç inventarit dhe tatimit te shtyre aktiv rishikohen ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka ndonje tregues zhvleresimi. Nese nje tregues i tille ekziston atehere matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel eshte me e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershiresë.

Shuma e rikuperueshme e nje aktivi eshte vlera me e madhe mes vleres ne perdorim dhe vleres se tregut minus kostot e shitjes. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen me nje norme skontimi para tatimi qe reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqet specifike qe lidhen me aktivin.

Humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohen ne çdo date raportimi per ndonje tregues rreth zvogelimit ose eliminimit te humbjes. Nje humbje nga zhvleresimi rikthehet nese ka pasur nje ndryshim ne treguesit e perdorur per te percaktuar shumen e rikuperueshme. Nje humbje nga renia ne vlere rimerret vetem ne masen ne te cilen vlera kontabel e aktivit nuk e kalon vleren e aktivit qe duhej te percaktohej neto nga amortizimi dhe zhvleresimi nese asnje humbje nga renia ne vlere nuk do te ishte njohur

d) Perfitimet e punonjesve

Sigurim i detyrueshem shoqeror

Shoqeria paguan vetem kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore te cilat percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per percaktimin e kufirit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh te percaktuara. Kontributet e Shoqerise per planin e pensionit i ngarkohen fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

Pushimi vjetor i paguar

Shoqeria njeh si detyrim vleren e paskontuar te kosos se vleresuar lidhje me lejen vjetore qe pritet te paguhet ne kembim per sherbimin e punonjesve ne periudhen.

e) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme te emetuara klasifikohen si kapital aksionar.

f) Provizionet

Te pergjithshme

Nje provizion njihet nese si rezultat i nje ngjarjeje te kaluar, kur Shoqeria ka nje detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe parashikohen flukse dalese mjeteshe monetare per shlyerjen e ketij detyrimi. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te mjeteve monetare me nje norme para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet specifike te detyrimit.

Detyrime per cmontime

Shoqeria regjistron një provizion për kostot e çmontimit të një njësie për ruajtjen e produkteve. Kostot e çmontimit krijohen në vlerën aktuale të kostove të pritshme për të shlyer detyrimin duke përdorur flukset monetare të vlerësuara dhe njihen si pjesë e kostos së aktivitetit përkatës. Flukset e mjeteve monetare zbriten në një normë aktuale para-tatimore që pasqyron rreziqet specifike për detyrimin e çmontimit. Zbritjet si të lindura njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes si një kosto financiare. Kostoja e ardhshme e çmontimit rishikohet çdo vit dhe përshtatet sipas nevojës. Ndryshimet në kostot e ardhshme të vlerësuara, ose në normën e skontimit të aplikuar, shtohen ose zbriten nga kostoja e aktivitetit.

g) Te ardhurat nga kontrata me klientet

Te ardhurat nga shitja e mallrave jane vleresuar me vleren e drejte te shumave te arketuara ose te pritshme per tu arketuar neto nga tatimi mbi vleren e shtuar, akciza, kthimet dhe zbritjet tregtare dhe financiare. Te ardhurat njihen kur rreziqet dhe perfitimet e rendesishme te lidhura me pronesine transferohen tek bleresi, kur ka mundesi qe perfitimet te lidhura me shitjen te hyjne ne Shoqeri, kostot dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te vleresohen ne menyre te besueshme, drejtimi nuk perfshihet me ne administrimin dhe kontrollin efektiv te mallrave dhe kur vlera e te ardhurave mund te vleresohet ne menyre te besueshme.

h) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese. Te ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese me metoden e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kursi i kembimit raportohen mbi baza neto.

i) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe ate te shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese pervec rasteve kur njohja behet direkt ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit duke perdorur normat tatimore te miratuara ne daten e raportimit dhe çdo rregullim te tatimit te pagueshem nga vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e bilancit, duke marre ne konsiderate diferencat e perkohshme midis vleres se mbetur te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe shumat e perdorura per qellime tatimore. Tatimi i shtyre llogaritet me normat tatimore qe aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato rimerren bazuar ne legjislacionin e miratuar ne daten e raportimit. Detyrimet dhe aktivet tatimore te shtyra kompesohen nese ka nje mareveshje ligjore per ti kompesuar dhe nese ato lidhen me tatime mbi fitimin te vendosura nga i njejti autoritet tatimor. Nje aktiv tatimor i shtyre njihet deri ne masen qe eshte e mundshme qe te ketepfitime te ardhshme tatimore te vlefshme ndaj te cilavediferencat e perkohshme mund te rimerren Me 31 dhjetor 2017 nuk eshte njohur asnje aktiv tatimor i shtyre sepse drejtimi vlereson qe nuk eshte e mundur qe nje perfitimi tatimor i ardhshem ne lidhje me to te realizohet.

5. Manaxhimi i riskut financiar

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor i operacioneve të Shoqerise. Rreziqet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Shoqeria janë ato që lidhen me rrezikun e tregut, që përfshin çmimin, normën e interesit dhe rreziqet e monedhës, rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqerise kanë për qëllim identifikimin, analizimin dhe menaxhimin e rreziqeve me të cilat ballafaqohet Shoqeria, vendosjen e limiteve dhe kontrollit të duhur të rrezikut dhe monitorimin e vazhdueshëm të niveleve të rrezikut dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe praktikatat më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i Shoqerise në bashkëpunim të ngushtë me dhe mbikëqyrjen nga strukturat e menaxhimit të rrezikut të grupit ka përgjegjësinë e përgjithshme për mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut, mbikëqyrjen e menaxhimit të rreziqeve kryesore dhe rishikimin e politikave dhe procedurave të administrimit të rrezikut si dhe miratimin e transaksioneve të mëdha.

Të dy faktorët e rrezikut të jashtëm dhe të brendshëm identifikohen dhe menaxhohen në të gjithë strukturën organizative të Shoqerise, dhe veçanërisht nga strukturat e menaxhimit të rrezikut në nivel grupi.

Risku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në çmimet e tregut, duke përfshirë normat e këmbimit valutor, normat e interesit, përhapjet e kredisë do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqerise. Rreziqet e tregut përfshijnë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun tjetër të çmimeve. Rreziku i tregut vjen nga pozicionet e hapura në normën e interesit, valutës dhe mallrave të tjera të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e paqëndrueshmërisë së çmimeve të tregut.

Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

Risku i normes se interes

Rreziku i normës së interesit është rreziku që lëvizjet në normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqerise ose në vlerën e portofolave të saj të instrumenteve financiare.

Meqenëse Shoqeria nuk ka asete me interes të konsiderueshëm, të ardhurat e saj dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë kryesisht në huamarrjet me normë të ndryshueshme duke ndryshuar fluksin e ardhshëm të parasë. Drejtimi nuk ka një politikë formale për të përcaktuar se sa nga huamarrjet e Shoqerise duhet të jenë në norma fikse ose të ndryshueshme. Megjithatë, në kohën e marrjes së huave të reja, menaxhmenti përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse beson se një normë fikse ose variabile do të ishte më e favorshme për Shoqërinë gjatë periudhës së pritshme deri në maturim.

Risku i monedhes

Shoqeria ka aktive dhe detyrime të shprehura në USD dhe Euro. Rreziku i valutës lind kur aktivet aktuale ose të parashikuara në një monedhë të huaj janë më të mëdha ose më të vogla se detyrimet në atë monedhë.

Risku i kredise

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe rrjedh kryesisht nga të arkëtueshmet e Shoqërisë nga klientët e saj.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Shoqëria krijon një zbritje për zhvlerësim që paraqet vlerësimin e tij të humbjeve të shkaktuara në lidhje me tregtinë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme. Zhvlerësimi llogaritet në bazë të analizës së balancave individuale.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare në momentin e duhur. Qasja e Shoqërisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tij kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe të stresuara, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

Në mënyrë tipike Shoqëria siguron që ka para të gatshme të mjaftueshme për të përmbushur shpenzimet e pritura operationale, duke përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin e mundshëm të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, të tilla si fatkeqësitë natyrore.

Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë për të siguruar kthimin e aksionarëve dhe për të ruajtur një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit. Kapitali total llogaritet si 'kapitali' siç tregohet në pasqyren e pozicionit financiar plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si huamarrje e përgjithshme, siç tregohet në pasqyren e pozicionit financiar duke zbritur mjete monetare.

Shoqëria financohet me kapital minimal dhe kryesisht me huazime të brendshme dhe të pagueshme për palët e lidhura. Mema e Shoqërisë konfirmoi se është politika e saj e tanishme për të siguruar që Shoqëria është në gjendje të përmbushë detyrimet e borxheve dhe shpenzimeve të investimeve kapitale kur ato të jenë në gjendje të paguajnë. Mema e Shoqërisë gjithashtu konfirmoi se ata do të ofrojnë mbështetje për Shoqërinë për të siguruar se ata do të kenë fonde adekuate për të përmbushur detyrimet e tyre kur ato të marrin pjesë. Shoqëria nuk i nënshtrohet kërkesave të kapitalit të imponuara nga jashtë.

6. Adoptimi i standarteve dhe interpretimeve te reja dhe te rishikuara.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit.

Standarti eliminon modelin aktual të kontabilitetit të dyfishtë për qiramarrësit dhe në vend të saj kërkon që shoqëritë të pasqyrojnë qiratë në bilanc sipas një modeli të vetëm, duke eliminuar dallimin mes qirasë operative dhe financiare.

Sipas SNRF 16, kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për kontrata të tilla, modeli i ri kërkon që qiramarrësi të njohë një aktiv për të cilin ka të drejtën e përdorimit si dhe një detyrim. Aktivi zhvlerësohet dhe detyrimi akumulon interes. Kjo do të rezultojë në një model ku shpenzimet janë më të larta në periudhën fillestare dhe më pas vijnë duke u ulur për shumicën e qirave, edhe nëse qiramarrësi paguan këste fikse vjetore.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat e standartit për:

- qiratë afatshkurtra dhe;
- qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët

7. Standardet e reja të pa-adoptuara dhe amendimet

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë, janë paraqitur më poshtë:

- Ndryshimet në Kuadrin Konceptual (në fuqi më 1 janar 2020).
- Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e biznesit" (në fuqi më 1 janar 2020).
- Ndryshimet në SNK 39 "Instrumentat financiar: Njohja dhe matja", SNRF 7 "Informacionet shpjeguese për instrumentat financiar", dhe SNRF 9 "Instrumentat financiar" (në fuqi më 1 janar 2020).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021)

8. Aktive afatgjata

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh materiale në vlerën **622,101.517 ALL** neto te detajuar si më poshtë :

| | <i>Mjete transporti</i> | <i>Makineri e pajisje</i> | <i>Pajisje informatike</i> | <i>Ndertime</i> | <i>Toka</i> | <i>Totali</i> |
|----------------------------------|-----------------------------|-------------------------------|--------------------------------|--------------------|--------------------|----------------------|
| Aktive te Trupezuara | | | | | | |
| Gjendje 01.01.2022 | 327,678,267 | 239,444,276 | 102,382,116 | 198,914,638 | 143,173,558 | 1,011,592,854 |
| Shtesa | 25,790,330 | 58,558,006 | 13,104,702 | 22,784,088 | 40,337,900 | 160,575,027 |
| Pakesime | 13,822,957 | 11,726,244 | | | | 25,549,201 |
| Gjendje 31.12.2022 | 339,645,640 | 286,276,038 | 115,486,818 | 221,698,726 | 183,511,458 | 1,146,618,680 |
| Amortizimi | | | | | | |
| Gjendje ne 01.01.2022 | 162,966,598 | 144,462,289 | 80,336,771 | 67,848,808 | - | 455,614,466 |
| Shtesa llogaritur | 37,799,666 | 14,397,443 | 9,913,265 | 7,366,392 | | 69,476,766 |
| Pakesime | | | 574,069 | | - | 574,069 |
| Gjendje ne 31.12.2022 | 200,766,264 | 158,859,732 | 89,675,967 | 75,215,200 | | 524,517,163 |
| Vlera neto 31.12.2021 | 164,711,669 | 94,981,986 | 22,045,345 | 131,065,830 | 143,173,558 | 555,978,388 |
| Vlera neto 31.12.2022 | 138,879,376 | 127,416,306 | 25,810,851 | 146,483,526 | 183,511,458 | 622,101,517 |

Inventari i aktiveve afatgjata materiale është vlerësuar me koston e marrjes së tyre. Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale është llogaritur sipas normave të vendosura në seksionin perkates të politikave kontabël.

9. Investime ne pjesmarrje më 31.12.2021 janë interesat e kapitalit të subjektit Prince Coffe Shop, kompani të cilën e zotëron Tobacco Holding Group me 100 % të kuotave dhe me date 18/09/2020 ka blere 49 % te kapitalit te shoqerise Natsky shpk.

10. Aktivet monetare përfaqësojnë gjendjet në bankë dhe vlerat në arkë. Për llogaritë në valutë është bërë azhormimi me kursin e dates 31.12.2022 dhe ato detajohen si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|---------------|--------------------------|---------------------------|
| Para ne Banka | 82,562,921 | 181,178,052 |
| Arka | 2,310,392 | 757,467 |
| Totali | <u>82,873,313</u> | <u>181,935,519</u> |

11. Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme me 31.12.2022 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|---------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Kërkesa te arketueshme | 213,566,892 | 158,829,261 |
| Te drejta ndaj te treteve | 378,876,999 | 352,435,060 |
| Të tjera te arketueshme | 60,801,369 | 80,471,364 |
| Totali | <u>653,245,259</u> | <u>591,735,684</u> |

11.a Kërkesat e arketueshme përfaqësojnë detyrimet e klienteve për t'u arkëtuar pas datës 31 Dhjetor 2022.

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|---------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Kliente per mallra dhe sherbime | 213,566,892 | 158,829,261 |
| | <u>213,566,892</u> | <u>158,829,261</u> |

11.b Të drejta ndaj të tretëve më të rëndësishme më datë 31 Dhjetor 2022 detajohen si me poshte:

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|--|---------------------------|---------------------------|
| | <u>378,876,999</u> | <u>352,435,060</u> |

11.c Të tjera të arkëtueshme kanë lidhje me të drejtat nga Tvsh kreditore më 31.12.2022

| | <u>31 Dhjetor 2021</u> | <u>31 Dhjetor 2020</u> |
|----------------|--------------------------|--------------------------|
| TVSH kreditore | 60,801,369 | 49,480,279 |
| | <u>60,801,369</u> | <u>49,480,279</u> |

12. Inventarët me 31.12.2022 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|----------------------|-----------------------------|---------------------------|
| Produkte dhe mallra | 201,896,972 | 257,827,272 |
| Produkte ne manifest | 130,896,972 | 161,859,172 |
| Punime në proces | 857,055,065 | 566,427,637 |
| Totali | <u>1,189,344,982</u> | <u>986,114,081</u> |

13. Te tjera aktive afatgjata me 31.12.2022 përfaqësojnë shpenzime të periudhave të ardhshme nga të cilat

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|-------------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Pulla tatimore, bileta, te tjera me vlere | 34,103,186 | 22,737,408 |
| Ngurtesimi i fondeve per LG | 6,941,747 | 11,871,275 |
| Projekti ndertimor & takse bashkie | 250,302,736 | 250,302,736 |
| | <u>291,347,669</u> | <u>284,911,419</u> |

14. Detyrime afatgjata më 31.12.2022 përfaqësojnë pjesen afatgjate te detyrimit ndaj Leasing për blerje të makinave me qera financiare ne vleren 35,881,542 ALL.**15. Detyrime afatshkurtra përfaqësojnë detyrime për t'u paguar pas datës 31.12.2022 dhe detajohen si më poshtë:**

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|---------------------------------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| Furnitore per mallra dhe shpenzime | 394,353,821 | 474,059,650 |
| Detyrime ndaj klienteve per kontratat e ndertimit | 580,116,474 | 370,858,783 |
| Hua afatshkurtra | 1,333,861,985 | 1,285,173,951 |
| Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve | 2,590,131 | 2,287,192 |
| Detyrime per tatimin aktual | 3,618,372 | 812,128 |
| | <u>2,314,50,783</u> | <u>2,133,191,704</u> |

15.a Të pagueshme ndaj funitorëve

Furnitorët e kompanisë më 31.12.2022 paraqiten si më poshtë :

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|---------------|---------------------------|---------------------------|
| Furnitore | 394,353,821 | 474,059,650 |
| Totali | <u>394,353,821</u> | <u>474,059,650</u> |

15.b Huate afatshkurtra me 31.12.2022 detajohen si me poshte:

Vlera e huasë përfaqëson gjendjen më 31.12.2022 të huave të marra nga Otp Bank dhe ABI Bank.

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|--------------------------|------------------------|------------------------|
| Societe Generale Albania | 1,278,244,632 | 1,228,828,224 |
| ABI Bank | 50,561,705 | 56,345,727 |
| Porsche leasing | 5,055,648 | 14,991,628 |
| Credins Leasing | 35,881,542 | 36,934,715 |
| | <u>1,333,861,985</u> | <u>1,300,165,579</u> |

16.c Detyrime ndaj klienteve per kontratat e ndertimit më 31.12.20201ne vleren 580,116,474 përfaqësojnë parapagimet e klienteve per blerje ambientesh ne objektin ku po investon Kompania sipas lejes se ndertimit Nr X-14129/8, Date 16.08.2018. Per keto parapagime jane prere fatura tatimore shitjeje per paradheniet, ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per Tatimin mbi Vleren e shtuar"

16.d Detyrime për sigurime dhe tatimore

Detyrimet tatimore të detajuara me 31 Dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2022</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|---------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| TAP | 840,118 | 794,868 |
| Tatim ne burim | 17,262 | 17,260 |
| Tatim fitimi | | |
| Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve | 2,590,131 | 2,287,192 |
| | <u>3,447,511</u> | <u>3,099,320</u> |

17. Te ardhurat nga aktivitetet e vazhdueshme për vitin 2022 detajohen si me poshte:

Shoqëria për vitin 2021 ka realizuar të ardhura nga shitja e produkteve si më poshtë:

| | <u>Viti 2022</u> | <u>Viti 2021</u> |
|-------------------------------------------|----------------------|----------------------|
| Shitjet Neto te produkteve | 9,351,871,169 | 7,991,324,238 |
| Të ardhura të tjera nga shitja e aktiveve | 25,822,731 | 48,531,043 |
| Totali | <u>9,377,693,899</u> | <u>8,039,855,281</u> |

18. Shpenzime për Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme përfshin kostot e mallit të shitur gjatë vitit 2022 si më poshtë:

| | <u>Viti 2022</u> | <u>Viti 2021</u> |
|------------------|----------------------|----------------------|
| Kosto e mallrave | 8,717,624,971 | 7,446,188,408 |
| Totali | <u>8,717,624,971</u> | <u>7,446,188,408</u> |

19. Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto detajohen si më poshtë:

| | <u>Viti 2022</u> | <u>Viti 2021</u> |
|----------------------------------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | 41,857,713 | 26,304,465 |
| Shpenzime të tjera financiare | (4,364,074) | (882,530) |
| | <u>37,493,639</u> | <u>25,421,934</u> |

Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme në vlerën 41,857,713 lekë përfaqësojnë interesat e kredisë afatshkurtër.

20. Shpenzime të tjera detajohen si më poshtë:

| | <u>Viti 2022</u> | <u>Viti 2021</u> |
|--------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Blerje energji, avull, uje | 5,051,128 | 2,797,335 |
| Kancelari | 893,982 | 1,007,809 |
| Qira | 20,896,938 | 19,900,572 |
| Mirembajtje dhe riparime | 16,832,520 | 16,777,331 |
| Prime te sigurimit | 12,954,670 | 12,536,723 |
| Sherbim sigurimi (roje) | 8,005,543 | 7,432,000 |
| Te ndryshme | 15,683,303 | 9,620,378 |
| Reklama, publicitet | 73,481,547 | 60,376,970 |
| Transferime, udhetime e dieta | 12,447,886 | 8,790,168 |
| Shpenzime postare e telekom | 3,388,242 | 2,996,133 |
| Karburant | 62,828,973 | 45,376,461 |
| Sherbime bankare | 3,352,088 | 13,315,557 |
| Konsulenca | 2,163,571 | 4,343,214 |
| Vlera kontabel e aktiveve te shitura | 24,975,131 | 47,018,176 |
| Shpenzime taksa | 2,744,899 | 2,973,528 |
| Shpenzime per pritje dhe dhurata | | 2,970,233 |
| Penalite, gjoba e demshperblime | 606,369 | 1,606,654 |
| | 3,153,125 | - |
| Shpenzime Avokatie | 5,051,128 | 6,297,092 |
| Totali | <u>269,459,921</u> | <u>266,136,334</u> |

21. Fitimi i vitit ushtrimor

Fitimi neto llogaritur në përputhje me kërkesat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat " duke marrë parasysh shpenzimet e konsideruara si të panjohura për llogaritjen e tatim fitimit.

| | <u>Viti 2022</u> | <u>Viti 2021</u> |
|--------------------------|--------------------|-------------------|
| Fitim Bruto | 153,892,142 | 116,322,710 |
| Shpenzime te panjohura | 606,370 | 1,606,654 |
| Baza llogaritjes Tatimit | 153,892,142 | 117,929,364 |
| % e tatim Fitimit | 15 | 15 |
| Tatim Fitimi | <u>23,174,777</u> | <u>17,689,405</u> |
| Fitimi NETO | <u>130,717,365</u> | <u>98,633,306</u> |

Per llogaritjen e taim fitimit jane marre parasysh kerkesat e ligjit "Per tatimin mbi te ardhurat ne Republiken e Shqiperise"

22. Tatimi i shtyrë

Shoqëria ka analizuar të gjitha efektet e mundshme për diferenca të përkohshme të cilat do të rezultonin në një aktiv/detyrim të shtyrë dhe tatim të shtyrë. Mosekzistenca e diferencave të përkohshme ka sjelle mosnjohjen e tatimeve të shtyra.

23. Instrumentat financiarë

Si rezultat i përdorimit të instrumenteve financiare Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme:

Rreziku i kredise

Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që një palë e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për Shoqërinë duke mos paguar detyrimin. Risku i kreditimit është më i rëndësishmi ndaj të cilit përballet Shoqëria dhe si rrjedhim Drejtimi duhet ta menaxhojë me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kreditimit.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare perfaqeson ekspozimin maksimal ndaj rrezikut te kredise. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut te kredise ne daten e raportimit eshte si me poshte:

| | <u>31 Dhjetor 2021</u> | <u>31 Dhjetor 2021</u> |
|--------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Llogari te arketueshme (Shenimi 6.a) | 213,566,892 | 158,829,261 |
| Mjete monetare (Shenimi 5) | 82,873,313 | 181,178,052 |
| Totali | <u>296,440,205</u> | <u>340,007,312</u> |

Të gjitha te drejtat e arkëtueshme janë të mbledhshme për më pak se një vit në datën e raportimit.

Te drejtat e arketueshme dhe te tjera te arketueshme jane klasifikuar si te pazhvleresuara ne daten e raportimit dhe vlera e zhvleresimit eshte zero.

| | Pa ditevonesa dhe te pa zhvleresuar | Me ditevonesa por te pa zhvleresuar | Te zhvleresu ar | Totali |
|------------------------|----------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------|---------------------------|
| 2022 | | | | |
| Llogari te arketueshme | 213,566,892 | 0 | 0 | <u>213,566,892</u> |

Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjëndje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Me poshte eshte paraqitur maturiteti sipas kontratave te detyrimeve financiare, duke perfshire pagesat e interesit dhe duke perjashtuar ndikimin e marreveshjeve te kompesimit:

| | 2022 | 0-6 Muaj | 6-12 Muaj | Totali |
|-------------------------------------|------|---------------------|-----------|---------------------|
| Mjete monetare | | 82,873,313 | - | 80,873,313 |
| Llogari te arketueshme | | 213,566,892 | - | 213,566,892 |
| Te tjera te arketueshme | | 60,801,369 | - | 60,801,369 |
| Detyrime financiare - jo derivative | | 0 | 0 | 0 |
| Furnitore dhe detyrime te tjera | | 394,353,821 | 0 | 394,353,821 |
| | | (37,112,247) | 0 | (37,112,247) |

Rreziku nga monedha

Shoqëria përballlet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

Shoqëria ka ekspozim ndaj rrezikut te monedhave te huaja si me poshte:

| 2022 | Lek | EUR | USD |
|---------------------------------|--------------------|-------------|--------------|
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 81,754,319 | 8750 | 1,334 |
| Llogari te arketueshme | 213,566,892 | 0 | 0 |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Furnitore dhe detyrime te tjera | 394,353,821 | 0 | 0 |
| Hendeku sipas monedhave | -99,032,610 | 8750 | 1,334 |

Reziku nga normat e interesit

Shoqëria mund të përballet me rrezikun e normës së interesit të huamarrjeve afatgjata. Shoqëria financon pjesën më të madhe të aktivitetit përmes huave të forms overdraft, si rrjedhojë ky rrisht është minimal.

Ne datën e raportimit profili i normës së interesit për Shoqërinë nuk është neutral pasi Shoqëria nuk ka aktive financiare, por ka ose detyrime financiare.

| 2022 | Lek | EUR | USD |
|------------------------------|--------------------|--------------------|----------|
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Aktive financiare | 0 | 0 | 0 |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Detyrime financiare | -55,617,353 | -11,190,095 | 0 |
| Hendeku sipas monedhave | -55,617,353 | -11,190,095 | 0 |

Analiza e ndikimit nga vlera e drejte e instrumentave financiare me norme interesi te pandryshueshme

Shoqëria nuk ka ndonjë instrument financiar me norme interesi të pandryshueshem të klasifikuar si i mbajtur me vlerë të drejtë në fitime/humbje, dhe shoqëria nuk përdor derivative. Prandaj ndryshimet në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojnë në fitimet ose humbjet.

24. Angazhimet dhe aktivet/detyrimet e kushtezuara

Mjedisi i aktivitetit të Shoqërisë

Legjislacioni tatimor dhe doganor në Republikën e Shqipërisë është subjekt i interpretimeve të ndryshueshme, ndryshimeve të shpeshta dhe gjithashtu shumë shoqëri që operojnë aktualisht në Shqipëri po përballen me sfida që vijnë nga pengesa të tjera ligjore dhe fiskale. Vazhdimësia ekonomike e Republikës së Shqipërisë varet shumë nga efektiviteti i masave ekonomike financiare dhe monetare të ndërmara nga Qeveria së bashku me zhvillimet në reformat ligjore rregullatore dhe politike.

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në gjendje të parashikojë të gjitha zhvillimet në mjedisin ekonomik të cilat do të kenë një impakt në veprimet e Shoqërisë dhe për pasojë mund të kenë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë. Në klimën aktuale të zbatimit të legjislacionit egzistues drejtimi beson se nuk ka detyrime të rëndësishme për dëmtimet mjedisore.

- **Çështjet ligjore që kanë ndikim në shoqëri**

Aktualisht janë në shqyrtim gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij raporti nuk ka çështje të rëndësishme ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

- **Kushtezimet tatimore**

Sistemi tatimor në Shqipëri është relativisht i ri dhe karakterizohet nga ndryshime të shpeshta në legjislacion deklarime zyrtare dhe vendime gjyqësore të cilat shpesh janë të paqarta, kontradiktore dhe subjekt i interpretimeve të ndryshueshme nga autoritete

te ndryshme tatimore. Tatimet dhe taksat jane subjekt i rishikimit dhe kontrollit nga nje numer autoritetesh te cilet kane autoritetin te vendosin detyrime gjoba dhe interesa te larta. Te dhenat e nje viti fiskal mbeten te hapura per rishikim nga autoritetet tatimore gjate pese viteve te ardhshem kalendarike megjithate ne disa rrethana nje vit fiskal mund te mbetet i hapur per nje kohe me te gjate. Ngjarjet e fundit ne Shqiperi tregojne qe autoritetet tatimore po marrin nje pozicion me te sigurte dhe kategorik ne interpretimet e tyre dhe ne zbatimin e legjislacionit tatimor.

Keto rrethana mund te krijojne nje rrezik tatimor ne Shqiperi qe eshte shume me i madh sesa ne vende te tjera. Drejtimi beson se ka njohur detyrimet tatimore ne baze te interpretimeve te legjislacionit aktual tatimor ne Shqiperi deklaratave zyrtare dhe vendimeve gjyqesore. Megjithate interpretimet e ndryshme te disa autoriteteve per zbatim mund te ndikojne ndjeshem ne zerat e ketyre pasqyrave financiare.

25. Transaksionet me palet e lidhura

Transaksionet me palet e lidhura jane paraqitur si me poshte:

| | <u>2022</u> | <u>2021</u> |
|---------------------------------|-------------|-------------|
| Dhenie hua kompanive te lidhura | 378,876,999 | 352,435,060 |

Te gjitha gjendjet e mbetura me palet e lidhura duhet te paguhen deri ne 12 muaj nga data e bilancit. Asnje nga gjendjet nuk eshte e siguruar. Gjithe transaksionet kryhen ne kushte tregu.

26. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës së bilancit për të cilat nuk behen rregullime nuk ka.
Gabime materiale të ndodhura në periudhat kontabël të mëparshme të konstatuara gjatë periudhës raportuese dhe që korigjohen nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Brunilda Keco

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike
Valbona Begu

